



VENDIM MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË PANELIT

Data e miratimit: 29 shkurt 2016

Numri i lëndës: 2012-22

Desanka dhe Zoran Stanisic

kundër

EULEX-it

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut i mbledhur me 29 shkurt 2016, ku të pranishëm ishin anëtarët e paraqitur në vijim:

Znj. Magda MIERZEWSKA, kryesuese
Z. Guénaël METTRAUX, anëtar
Znj. Katja DOMINIK, anëtare

Ndihmuar nga
Znj. Joanna MARSZALIK, zyrtare ligjore
Z. Paul LANDERS, zyrtar ligjor

Pas shqyrtimit të ankesës së lartpërmendur, e cila është dorëzuar në përputhje me Veprimin e Përbashkët të Këshillit 2008/124/CFSP të datës 4 shkurt 2008, Konceptin Llogaridhënës të EULEX-it të datës 29 tetor 2009 për themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut dhe rregullores së punës së Panelit siç është ndryshuar së fundi më 15 janar 2013,

Pas shqyrtimit, u vendos si në vijim:

I. VENDIMI I PANELIT I DATËS 11 NËNTOR 2015

1. Më 11 nëntor 2015, Paneli ka marrë vendim në lidhje me ankesën e paraqitur nga ankuesi kundër EULEX-it dhe i ka dhënë një sërë rekomandimesh shefit

të Misionit (ShM) në përputhje me rregullën 34 të rregullores së punës. Në pjesët përkatëse në vendim thuhet:

“PANELI, NJËZËRI

1. *Shpall* ankesat sipas nenit 3 të Konventës të papranueshme pasi qartazi janë të pabazuara;
2. *Konstaton* se nuk ka pasur shkelje të nenit 8 të Konventës;
3. *Gjen* një shkelje të nenit 13 të Konventës;
4. *Konstaton* se nuk është e nevojshme për të shqyrtuar çështjen sipas nenit 14 të Konventës.

dhe

DEKLARON

se në bazë të gjetjeve të mësipërme të fakteve dhe ligjit, Paneli gjen të përshtatshme që të bëjë rekomandime për ShM-në, dhe

REKOMANDON VEPRIMET E MËPOSHTME KORRIGJUESE

- a. ShM-ja duhet të bëjë një deklaratë ku pranon se rrethanat e rastit kanë përbërë një shkelje të të drejtave të ankuesve që i ngarkohen veprimeve [dhe/ose mosveprimeve] të EULEX-it gjatë kryerjes së mandatit të tij ekzekutiv;
 - b. ShM-ja duhet t'i ofroj një kopje të këtij vendimi prokurorëve të EULEX-it përmes kanaleve përkatëse. Kjo duhet të shërbej që të informohen prokurorët e EULEX-it rreth natyrës së përgjithshme të detyrimit të tyre për t'i përfshirë viktimat në hetimet e tyre dhe për të ofruar arsye të duhura rreth ndërprerjes së ndonjë hetimi në ndonjë rast të veçantë.”
2. Vendimi i tanishëm është vendim pasues i vendimit të Panelit të datës 11 nëntor 2015 dhe rekomandimeve të bëra në të.
 3. Kompetencat dhe autoriteti i Panelit për t'i përcjell vendimet dhe rekomandimet e tij është e dhënë në rregullën 45 e tutje të rregullores së punës (shih p.sh. vendimet mbi zbatimin e rekomandimeve [W kundër EULEX-it](#), 2011-07, 26 gusht 2014; [Becic kundër EULEX-it](#), 2013-03, 11 nëntor 2015).

II. INFORMACIONI I MARRË NGA SHEFI I MISIONIT TË EULEX-IT LIDHUR ME ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË PANELIT

4. Më 15 dhjetor 2015, ShM ka njoftuar Panelin rreth masave që ai i kishte marrë në këtë rast si përgjigje ndaj rekomandimeve të Panelit.
5. ShM-ja ka shprehur zyrtarisht keqardhjen e tij për faktin se ankuesit nuk ishin të përfshirë mjaftueshëm në procedurat hetimore dhe se atyre nuk ju ishin dhënë arsyet për përfundimin e hetimeve.
6. Në lidhje me rekomandimin e dytë të Panelit, ShM-ja ka treguar se vendimi i Panelit i datës 15 nëntor 2015 ju ishte shpërndarë prokurorëve të EULEX-it nga ushtruesi i detyrës së kryeprokurorit të EULEX-it. Në veçanti, prokurorët e EULEX-it ishin përkujtuar se në vendimet për pushimin e kallëzimeve penale duhet të përfshihet “një përmbledhje të shkurtër të arsyeve rreth vendimit”. Për më tepër, nevoja dhe arsyeshmëria e intervistimit të personin që e ka dorëzuar kallëzimin penal duhet të vlerësohet në çdo rast para se të lëshohet vendimi që të pushohet kallëzimi penal.

III. VLERËSIMI NGA PANELI

7. Paneli vëren hapat e ndërmarrë nga ShM-ja për të zbatuar rekomandimet e tij.
8. Paneli vëren se rekomandimi i tij i parë ishte për ShM-në që të bënte një deklaratë se pranon që rrethanat e rastit përbënin shkelje të të drejtave të ankuesve që i ngarkojë Misionit gjatë kryerjes së mandatit të tij ekzekutiv. Në letrën e tij të datës 15 dhjetor 2015, shefi i Misionit ka shprehur keqardhjen e tij se ankuesit nuk ishin të përfshirë sa duhej në procesin e hetimit dhe se atyre nuk ju ishin dhënë arsye të mjaftueshme për përfundimin e këtij procesi. Përderisa një përgjigje e tillë nuk përfshinë plotësisht rekomandimin e Panelit, keqardhja e shprehur nga shefi i Misionit përbën pranim të mangësive në procesin hetimor që në njëfarë mënyre shkon drejt asaj që ankuesve t'i ofrohen mjete juridike për shkeljen të drejtave të tyre.
9. Në vendimin e tij të datës 15 nëntor 2015, Paneli gjithashtu rekomandoj që ShM-ja duhet t'i ofroj kopjet e atij vendimi prokurorëve të EULEX-it përmes kanaleve përkatëse. Në letrën e tij, ShM-ja ka treguar se vendimi i Panelit në me të vërtetë ju ishte shpërndarë prokurorëve të EULEX-it nga ushtruesi i detyrës së kryeprokurorit të EULEX-it. ShM-ja më tej ka treguar se prokurorëve të EULEX-it ju ishin përkujtuar detyrimet e tyre për të ofruar një përmbledhje të shkurtër të arsyeve të tyre atëherë kur e hedhin poshtë kallëzimin penal dhe arsyeshmëria e intervistimit të personin që ka parashtruar kallëzimin penal duhet të vlerësohet në çdo rast. Paneli është i bindur se këto hapa janë konsistente dhe plotësisht në përputhje me rekomandimin e dhënë nga Paneli në këtë pikë.

10. Pas shqyrtimit të informacionit të dhënë nga ShM-ja lidhur me zbatimin e rekomandimeve të Panelit,

PANELI NJËZËRI

Deklaron se ShM-ja ka zbatuar shumicën e rekomandimeve të Panelit.

Vendos të mbyllur shqyrtimin e kësaj lëndë.

Për Panelin,

Joanna MARSZALIK
Zyrtare ligjore

Magda MIERZEWSKA
Kryesuese